

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim LLulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.ZH. nga Vushtrria Rr.”...” pn, të cilin e përfaqëson i autorizuari Z.Xh., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. Distribucioni në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson i autorizuari O.K., jurist i të paditurës, për shkak të anulimit të njoftimit dhe vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kthimin e tij në punë si dhe kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të t’paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.16/14, i datës 23.04.2014, në seancën jo publike të mbajtur me datë 20.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET ankesa e të autorizuarit të t’paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. Distribucioni në Mitrovicë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.16/14, i datës 23.04.2014, ashtu që vendoset: REFUZHET kërkesëpadia e paditësit A.ZH. nga Vushtrria Rr.”...””, me të cilën ka kërkuar që të anulohet njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës Nr.406, i datës 18.10.2010, dhe vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës Nr.396, i datës 18.10.2010, të detyrohet e paditura që paditësin ta kthej në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, e po ashtu të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë të ardhurat personale sipas kontratës së punës duke filluar nga dita e largimit nga puna e deri në ditën e kthimit të tij në punë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, SI E PABAZUAR.

II. DETYROHET paditësi që të paditurës në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguajë shumën prej 30 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.16/14, i datës 23.04.2014, me pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit A.ZH. si të themeltë. Me pikën II (dy) të dispozitivit e ka anuluar Njoftimin për shkëputjen e kontratës së punës nr.406, e datës 18.10.2010 dhe Vendimi i të paditurës KEK nr.396, e datës 18.10.2010, si të kundërligjshme.

Me pikën III (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën KEK në Prishtinë, që paditësin A.ZH. ta kthejë në punë dhe në detyrat e tij të punës në Distriktin e Mitrovicës apo në një vend tjetër që përkojnë me përgatitjet e tij profesionale.

Me pikën IV (katër) e ka urdhëruar të paditurën që paditësit t'ia kompenzon të gjitha pagat sipas kontratës së punës dhe përfitimet tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm e deri në ditën e kthimit të tij në punë, ndërsa me pikën V (pesë) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguajë paditësit shumën prej 673 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të t'paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Të autorizuarit të paditësit i është dorëzuar ankesa e të paditurës për përgjigje, por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 201, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të t'paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.ZH. nga Vushtrria përmes të autorizuarit të tij me datë 15.11.2010, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., Distribucioni në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës Nr.406, i datës 18.10.2010, dhe vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës Nr.396, i datës 18.10.2010, ndërsa paditësi të kthehet në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, e po ashtu t'ia kompensojë të ardhurat personale sipas kontratës së punës duke filluar nga dita e largimit nga puna e deri në ditën e kthimit të tij në punë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.16/14, i datës 23.04.2014, me të cilin e aprovon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie të punës te e paditura me kontratën e punës në kohë të pa caktuar nr.9100, të datës 01.06.2008.

E paditura me Njoftimin Nr.406, të datës 18.10.2010, ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit me arsyetim se paditësi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës e që është konstatuar në bazë të raportit të Auditimit të Brendshëm, ndërsa sipas vendimit të t'paditurës Nr.396, të datës 02.11.2010, vërtetohet se Drejtori

Ekzekutiv i Divizionit të Rrjetit, paditësit ia ka refuzuar kundërshtimin Nr.6824, të datës 22.10.2010.

Gjykata ka shtuar se duke vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit të dhëna me aktvendimin e saj Ac.nr.4926/12, i datës 30.12.2013, ka ardhur në përfundim se veprimet juridike të t'paditurës janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 11 dhe 26 të Ligjit të Punës dhe nenet 31, 32, 33, të Urdhëresës Administrative Nr.2003/2, të PSSP-së, për faktin se e paditura nuk e ka zhvilluar procedurën disiplinore të paraparë, duke mos formuar komisionin disiplinor dhe atë të ankesave që do të ishte i përbërë nga përfaqësuesit e sindikatës dhe së paku dy anëtar i cili do të ishte kompetent të vlerëson dhe të vendosë për përgjegjësinë e paditësit duke vërtetuar se sjelljet e tij a kualifikohen si shkelje të lehta apo të rënda disiplinore dhe më pastaj ky komision disiplinor sipas ligjit ka qenë i autorizuar që pas vërtetimit të gjendjes reale sipas bindjes së lirë të shqipton me vendim ndonjërin nga masat disiplinore të paraparë me ligje apo ta liron nga përgjegjësia disiplinore.

Në rastin konkret këto veprime juridike i ka ndërmarrë vetëm menaxheri i distriktit, e të cilat janë të pa pranueshme për arsyeje se i njëjti ka pasur të drejtë vetëm ta iniciojë procedurën disiplinore, e po ashtu paditësit i është pamundësuar që në rast pakënaqësie me vendimin e organit të shkallës së parë të bëjë kundërshtim në shkallën e dytë gjegjësisht në Komisionin e Ankesave, prandaj paditësit si pasojë e mos zhvillimit të procedurës disiplinore i është pamundësuar që të merret në pyetje pranë organit disiplinor dhe ti lejohet mbrojtja sipas zgjedhjes së tij, eventualisht për të vërtetuar gjendjen faktike, komisioni disiplinor në rast nevojë është dashur të del në vend shiqim e që në rastin konkret të drejtat e paditësit janë shkelur në mënyrë drastike.

Për pretendimet e të paditurës se njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës dhe vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishin të ligjshme dhe të bazuara në raportin e Auditimit të Brendshëm, gjykata ka vlerësuar se ky raport ka mund të jetë vetëm një bazë për inicimin e procedurës disiplinore, por nuk mund të jetë edhe fakt vendimtar në shkëputjen e marrëdhënies së punës pa u zhvilluar një procedurë e mirëfilltë disiplinore siç e parasheh urdhëresa administrative, ku do ti jepej mundësia paditësit për të paraqitur mbrojtjen e tij.

Lidhur me pretendimin tjetër të t'paditurës se palët raportet juridike të tyre i kanë rregulluar me kontratën e punës e cila për palët është ligj, gjykata ka arsyetuar se këto marrëdhënie palët i rregullojnë në mënyrë të pavarur dhe të ndershme duke u udhëhequr nga parimi i vullnetit të lirë, por punët juridike duhet të jenë në harmoni të plotë me të drejtën pozitive të punës dhe e kanë për obligim që Ligjin Themelor të Punës e së bashku me urdhëresat administrative ti zbatojnë në përpikëri.

Lidhur me kompensimin e pagave, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësi është larguar në mënyrë të kundërligjshme nga puna dhe mbi këtë bazë urdhëroi që të njëjtit t'ia kompensojnë të gjitha pagat sipas kontratës së punës si dhe përfitimet tjera të humbura gjatë kohës së largimit të paligjshëm e deri në ditën e kthimit të tij në punë, kurse për shpenzimet e procedurës kontestimore vendosi konform dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduar, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 11 paragrafi 1 pika c) e Rregullores Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe dispozitat e Urdhëresës Administrative Nr.2003/2, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut NR.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë dhe atë dispozitat nga neni 31, 32 dhe 33, të kësaj rregulloreje.

Deri te shkelja e këtyre dispozitave të sipërcituara përkatësisht të dispozitës së nenit 11 paragrafi 1 pika c) e Rregullores Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, ka ardhur për arsye se gjykata e shkallës së parë është fokusuar vetëm në zbatimin e procedurës disiplinore nga ana e të t'paditurës, pa iu dhënë rëndësi fakteve tjera vendimtare të çështjes siç janë: të gjeturat nga punëdhënësi për shkeljet e detyrave të punës nga ana e punëmarrësit në këtë rast paditësit dhe proporcioni i masës disiplinore në këtë rast shkëputja e marrëdhënies së punës në raport me veprimet e punëmarrësit të cilat janë kualifikuar si shkelje e detyrave të punës.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar Urdhëresës Administrative Nr.2003/2, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut NR.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, me referencë në nenin 26, të Rregullores Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, pasi që urdhëresa administrative e cituar nuk i referohet fare zbatimit të Rregullores Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, por i referohet Rregullores së UNMIK-ut NR.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë.

Gjykata do të duhej të ketë vlerësim të qartë se në rastin konkret themelimi i marrëdhënies së punës nga ana e paditësit me të paditurën e rrjedhimisht edhe ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk ka për bazë Rregulloren mbi UNMIK-ut Nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, por ka për bazë Rregulloren Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, pasi që këto dy rregullore përcaktojnë rregullat për dy kategori të ndryshme të subjekteve nga marrëdhënia e punës. Pra neni 26 i Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë ka përcaktuar mundësinë që PSSP të nxjerrë urdhëresë administrative për zbatimin e kësaj rregullore po në asnjë mënyrë nuk mund të zbatohet me analogji urdhëresa administrative e nxjerrë nga PSSP-ja e cila i referohet kategorisë së shërbyesve civil.

Me dispozitën e nenit 11 paragrafi 1 pika c), e Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës, përcaktohet shkëputja e kontratës në rastet e rënda të sjelljes së keqe të një punonjësi, ndërsa në nenin 11 paragrafi 5 pika a) parashihet se: *“Punëdhënësi do ta njoftojë punonjësin me shkrim me qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës. Ai njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës”* dhe në pikën b) të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Punëdhënësi do të mbajë një takim me punonjësin me ç’rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në rast se punonjësi është anëtarë i ndonjë sindikate ka të drejtë që në atë takim të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i asaj sindikate”* Këto veprime i ndërmerr punëdhënësi për ta zbatuar dispozitën e nenit 11. 2 të Rregullores Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë e që i referohet shkëputjes së kontratës së punës nga punëdhënësi në raste të rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi.

Në rastin konkret punëdhënësi ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitat e sipërcituara, pasi që fillimisht paditësit i ka dërguar ftesë për takim në të cilën ftesë është konstatuar se i njëjti do të njoftohet për statusin e mëtejme të marrëdhënies së punës për shkak të rezultateve të pakënaqshme në punë, pastaj është mbajtur takimi me datën 18.10.2010, për të cilin është mbajtur procesverbali dhe i është lëshuar paditësit njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës. Në arsyetim të njoftimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës është theksuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës bëhet për shkak të shkeljes së detyrave të punës të konstatuara nga Raporti i Auditimit të Brendshëm.

Kundër njoftimit për shkëputjen e kontratës së punës paditësi ka paraqit ankesë, ndërsa e paditura me vendimin e saj të datës 02.11.2010, e refuzon ankesën dhe e konfirmon vendimin mbi ndërprerjen e kontratës së punës. Në këtë vendim i është dhënë udhëzimi që pala e pakënaqur mund të iniciojë procedurën në gjykatën kompetente në afat prej 15 ditësh.

Gjykata e Apelit vlerëson se veprimet e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit janë veprime tërësisht të ligjshme në pajtim me nenin 11 paragrafi 1 pika c) të Rregullores Nr.2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë lidhur me nenin 11 paragrafi 3 pika b), e cila i referohet shkeljes së rëndë të detyrave të punës për shkak të vjedhjes, shkatërrimit, dëmtimit ose shfrytëzimit të paautorizuar të pasurisë së punëdhënësit.

Në këtë rast veprimet e paditësit të konstatuara nga Raporti i Auditimit të Brendshëm kualifikohen si veprime që përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave të punës, për çka Gjykata e Apelit vlerëson se masa e shqiptuar nga punëdhënësi është proporcionale me natyrën e shkeljes rrjedhimisht edhe e ligjshme. Pra me rastin e shqiptimit të ndërprerjes kontratës së punës punëdhënësi ka zbatuar në tërësi dispozitat për procedurën e njoftimit të shkëputjes së kontratës së punës dhe ka zbatuar dispozitat materialo-juridike në mënyrë adekuate sipas gjendjes faktike të konstatuar në Raportin e Auditimit.

Në procedurën gjyqësore gjykata ka administruar prova për vërtetimin e fakteve vendimtare të çështjes, por nga provat e administruara paditësi nuk ka arritur të provojë të kundërtën e të gjeturave nga punëdhënësi, prandaj Gjykata e Apelit vendosi që ta aprovojë ankesën e të t'paditurës ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe ta refuzojë si të pathemeltë kërkesëpadinë e paditësit.

Për shpenzimet e procedurës lidhur me ankesën gjykata vendosi konform dispozitës së nenit 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së, meqenëse e paditura në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor i kishte kërkuar shpenzimet të procedurës, përfshirë edhe shpenzimet për taksa gjyqësore, në këtë rast të paditurës i janë njohur shpenzimet e taksës së paguar për ankesë në vlerë prej 30 Euro.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 par 1, pika (e) e lidhur me nenin 201 të LPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 2043/14, me datë 20.09.2016

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v